

**Njoftim për përqendrim me të cilin Industria Ushqimore „VITAMINKA“ SHA Prilep
do ta ndajë veprimtarinë e prodhimit të vajit në një shoqëri të re
(lënda nr. 08-85/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 16.05.2025, e plotësuar më 29.05.2025, Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Industria Ushqimore VITAMINKA SHA Prilep, me seli në rr. Lece Koteski nr. 23, Prilep, synon të themelojë një shoqëri të re – Shoqëri për prodhim, tregti dhe shërbime FABRIKA PËR PRODHIMIN E VAJIT BRILIJANT SHPKNJP Shkup.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

Industria Ushqimore „VITAMINKA“ SHA Prilep si veprimtari kryesore ka prodhimin e kakaos, çokollatave dhe produkteve të ëmbëlsirave.

Industria Ushqimore VITAMINKA SHA Prilep, në shoqërinë e sapo themeluar – Shoqëri për prodhim, tregti dhe shërbime FABRIKA PËR PRODHIMIN E VAJIT BRILIJANT SHPKNJP Shkup, do të transferojë një pjesë të pasurisë së saj të tundshme dhe të patundshme, pas së cilës FABRIKA PËR PRODHIMIN E VAJIT BRILIJANT SHPKNJP do të funksionojë në mënyrë të pavarur me veprimtari të prodhimit të vajrave dhe yndyrave.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje është ende i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim deri te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

09.06.2025

Shkup